

MENDIM PARALEL

1. Unë, antari trupës gjykues Valbona Sanxhaktari, po parashtroj më poshtë argumentet e një arsytimi paralel, me arsytimin e vendimit nr.476, datë 16.11.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Eda Kaja, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethin Gjyqësor Durrës.

2. Arsytimi i këtij mendimi paralel lidhet me qëndrime të ndryshme në raport me qëndrimin e mbajtur nga trupa gjykuese mbi të ardhurat **në vlerën 10,002,316 lekë, nga bashkëshorti i subjektit, personi i lidhur, shtetasi E.K.**, realizuar si ortak i vetëm i shoqërisë “***” sh.p.k., për periudhën 3.7.2006 – 21.12.2009, *Autoshkolla ‘***’*, por që nuk afekton qëndrimin tim pro vendimmarrjes së trupës e cilia ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Eda Kaja.

3. Kam mbështetur dhe kam votuar pro argumenteve të trupës gjykuese për pjesën më të madhe të tyre dhe, duke veçuar në mënyrë të përmbledhur atë që trupa gjykuese ka vendosur në lidhje me mosnjohjen e të ardhurave nga veprimtaria tregëtare e shoqërisë “***”/ “***” sh.p.k., për periudhën 3.7.2006 – 21.12.2009, në shumën 10,002,316 lekë, të pretenduara nga subjekti, me arsytimin se nuk plotësojnë kriterin e të ardhurave të ligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës e duke mos i marrë në konsideratë në analizën financiare, si dhe arsytimin ligjor të kryer, si të pa mbështetur në ligj.

4. Në vlerësimin tim arsytimi i bërë nga shumica e trupit gjykues nuk vjen në harmoni me dispozitat ligjore e nënligjor Për Tatimin mbi të Ardhurat nga aktiviteti tregtar Biznes i Vogël, në Republikën e Shqipërisë. Arsytimi i përdorur se: “Referuar të dhënave tatimore të shoqërisë “***”/“***” sh.p.k. rezulton se ka realizuar fitim si shoqëri, për të cilin ka paguar tatimin e thjeshtuar mbi fitimin, por nuk rezulton të ketë shpërndarë dividendë te ortaku i vetëm i shoqërisë, E.K., duke nënkuptuar që ky fitim nuk është shpërndarë, por ka mbetur në shoqëri dhe, si i tillë, nuk mund të pretendohet nga subjekti si e ardhur e ligjshme për aq kohë sa nuk është shpërndarë dhe paguar tatimi sipas ligjit”, në vlerësimin tim nuk është i gabuar.

5. Në analizë të dispozitave ligjore, Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimet përkatëse të kohës “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, e akteve vijuese nënligjore, çdo tatimpagues, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 8 000 000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël. Të ardhurat e tatueshme apo fitimi i tatueshëm rezulton si diferencë midis: (a) të ardhurave gjithsej të realizuar gjatë periudhës tatimore me, (b) shpenzimet e njohura. Shkalla tatimore¹ e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm, për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri

¹ [Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël \(tatime.gov.al\)](http://tatime.gov.al)

në 8 (tetë) milionë lekë, është 0%. Çdo tatimpagues, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, është i detyruar që deri më 10 Shkurt të vitit që pason periudhën tatimore të dorëzojë deklaratën vjetore tatimore, ku të jepen hollësisht të ardhurat gjithsej, shpenzimet e zbritshme, fitimi i tatueshëm, tatimi për t'u paguar, si dhe çdo hollësi tjetër e përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës tatimore vjetore.

6. Në vlerësimin tim, trupi gjykues, pas kërkesës dhe dokumentacionit të paraqitur, nga subjekti i rivlerësimit për marrjen në konsideratë të të ardhurave nga veprimtaria e bashkëshortit të saj, nga aktiviteti tregtar si person juridik biznes i vogël, si dhe fakteve të dokumentuara nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve duhet të konsultonte legjislacionet në fuqi sipas kohës së ushtrimit të veprimtarisë, e të pranonte ato të ardhura si të ligjshme, pasi në vlerësim të dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi është e evidentuar se të ardhurat nga veprimtaria tregtare me qarkullim deri në 8.000.000 lekë i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël. Tatimpaguesit me qarkullim deri në 8.000.000 lekë, subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, referuar legjislacionit në fuqi paguajnë tatmin parapagim me këste çdo katër muajor. Këstet parapagim llogariten sipas skemave të miratuara nga Drejtoria e Tatimeve. Në muajin shkurt të vitit pasardhës ata duhet të paraqesin deklaratën tatimore vjetore lidhur me qarkullimin e kryer.

8. Për të gjitha sa më sipër, vlerësoj se subjekti rivlerësimit ka provuar se aktiviteti i bashkëshortit të saj ka qënë subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, e se ai ka paguar rregullisht tatimin e thjeshtuar me këste mujore. Po ashtu vetë Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës ka konfirmuar mbi aktivitetin tregtar të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, e për pasojë trupi gjykues duhet të kish arritur në konkluzinin se këto të ardhura janë të ligjshme e se duhen njohur e përfshirë në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.

9. Në vlerësimin tim, mendoj se nuk gjendemi para një situatë për të konsideruar se subjekti nuk justifikon këto të ardhura me burime të ligjshme, pasi ato vijnë nga një aktivitet i njohur dhe i tatuar sipas legjislacionit të kohës. Përpos kësaj situatë, parimi kushtetues i sanksionuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, parashikon detyrimin e subjektit se ai duhet "të provojë bindshëm" burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave duke përcaktuar në këtë mënyrë një rol vendimtar të së drejtës diskrecionare të organeve të rivlerësimit për të kualifikuar pas një shqyrtimi të plotë çdo rast specifik, nëse provohet bindshëm ose jo ky element. Subjekti ka provuar, sa ka mundur, se aktiviteti i personit të lidhur bashkëshortit, ka qënë i ligjshëm dhe i ushtruar në përputhje me dispozitat e legjislacionit tatimor në vend. Ky informacion ishte në harmoni edhe me informacionet e ardhura nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve. Ishte detyrimi i Komisionit të vlerësonte provat dhe faktet e vëna në dispozicion nga subjekti rivlerësimit në raport me legjislacionin në fuqi të kohës. Në këtë kontekst, gjykoj se është e nevojshme që vlera e konsideruar si e pajustificuar në rezultatet e hetimit dërguar subjektit, të pranohej si një vlerë e sigurt dhe e ligjshme dhe të

konsiderohet në analizë financiare, mbështetur në një bazë dokumentare apo të dhënash të cilat gëzojnë një nivel të besueshëm, dhe rezultojnë në vlerësimin tim në përputhje dhe harmoni me legjislacionin në fuqi të kohës. Ky vlerësim korrekt i situatës faktike të subjektit të rivlerësimit, nuk do të ndryshonte rezultatin e procesit të rivlerësimit ndaj saj, por do të ndimonte për të ndërtuar një situatë të qëndrueshme dhe sa më të saktë të situatës në të cilën ndodhet subjekti i rivlerësimit.

Valbona Sanxhaktari

Komisionere